

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjergj Luca nga qyteti ku fëmijët bëhen kapitenë të ëndrrave: Kjo është vlera më e madhe e Rozafa Apol loni
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/gjergj-luca-nga-qyteti-ku-femijet-behen-kapitene-te-endrrave-kjo-eshte-vlera-me-e-madhe-e-rozafa-apolloni/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 11:01:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 10:56:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f033d06c06326bb39d328e24fe872981dd5905bed82269543e81ead9be1f5dbb
TEKSTI	6c96045dfcef3e3938da45177cee7abb7cd81a2a6450409924bd92d1ff1d34c7
PAMJA	e2523905ad30be4cfb486fcace2bbb56abd284ca916af19521fe69a25bf44632

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d29d197ab2406676055c69456aebc22478e5dc12d8e1302d924fcaaad0b188ad
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c13049b8c76e790ba04e601561e0fbdf5bb40424b3beb99843a4ea880b55b30
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d29d197ab2406676055c69456aebc22478e5dc12d8e1302d924fcaaad0b188ad>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gjergj Luca nga qyteti ku fëmijët bëhen kapitenë të ëndrrave: Kjo është vlera më e madhe e Rozafa Apolloni

AKTUALITET WEBTV E DIEL, 27 SHTATOR 2026 12:56

Nga Albert Vataj

Është e diel me diell dhe të qeshura fëmijësh në Fish City Apolloni. Është një ditë e bukur, por e magjishme është bota që ata i japin jetë me zërat dhe shkujdesjen e tyre. Ka gjëra që nuk maten me para, me sipërfaqe, me ndërtesa apo me numrin e njerëzve që punësohen. Ka një pasuri tjetër, më të rrallë dhe më të çmuar: buzëqeshjen e një fëmije. Dhe pikërisht aty, mes zërave, lojërave dhe gëzimit të fëmijëve, Gjergj Luca duket se gjen sot kuptimin më të bukur të asaj që ka ndërtuar, ëndërrës që ai i ka dhënë jetë.



Rozafa Fish City

Sipërmarrësi Gjergj Luca, njeriu pas një prej projekteve më të veçanta të kësaj filozofie sipërmarrjeje, Fish City Apolloni, është shfaqur këtë të diel të fundit të shtatorit mes fëmijëve, prindërve dhe familjeve që kanë zgjedhur ta kalojnë ditën në hapësirat e dedikuara për ta.

Në një vend ku dikur kishte vetëm fushë dhe horizont, sot është ngritur një qytezë, një hapësirë ku ideja është përpjekur të marrë formë konkrete dhe ku puna, investimi dhe këmbëngulja janë kthyer në një realitet të prekshëm.

Por Luca, këtë herë, nuk shfaqet mes zyrave, projekteve apo mjediseve të punës. Ai është aty ku gjithçka bëhet më e thjeshtë, mes fëmijëve që luajnë.

I qeshur, i çlirët, duke takuar prindër e të vegjël, ai bëhet pjesë e një atmosfere ku nuk ka rëndësi se kush është sipërmarrësi dhe kush është vizitori. Në atë hapësirë, të gjithë janë thjesht njerëz që gëzojnë një ditë të bukur.

Dhe ndoshta pikërisht këtu qëndron edhe një nga kuptimet më të bukura të një investimi, të krijosh një vend ku njerëzit të ndihen mirë.

Në videon e publikuar prej tij, Luca shprehet:

"Kompania Rozafa nuk njihet makutëri, nuk njihet babëzi. Rozafa ka vend e hapësira për fëmijët tuaj ku luajnë e argëtohen falas. Eja në Fier, eja në Elbasan, por jo vetëm. Sill edhe fëmijët të gëzojnë në shtëpinë e madhe Rozafa!"

Por fjalia që duket se përmbledh më mirë gjithë këtë qasje është ajo që ai thotë teksa shikon fëmijët: "Asgjë nuk ka vlerë veç lumturisë së këtyre fëmijëve."

Është një fjalë e thjeshtë, por me një peshë që shkon përtej një dite argëtimi.

Sepse çfarë kuptimi do të kishte një qytet, një biznes, një fabrikë, një ndërtesë apo një pasuri, nëse nuk do të kishte brenda tyre hapësirë për jetën?

Fëmijët janë ndoshta prova më e pastër e asaj që ndërtojmë. Ata nuk e matin një vend me madhësinë e tij, as me vlerën e investimit. E matin me një të qeshur, me një lojë, me një hapësirë ku mund të vrapojnë pa frikë, me një anije ku mund të hipin dhe, për pak çaste, të besojnë se janë kapitenë të botës.

"Shikoje se si e ka mbushur Zoti me gëzim", thotë Luca, teksa vështron fëmijët.

Dhe në atë çast, sipërmarrësi duket se harron për pak çaste gjithçka tjetër. Nuk është më njeriu që ndërton qyteza,

LAJMET KRYESORE



A do të shkojë ambasadori Wendt në Selinë Blu për të takuar Berishën?



Shqipëria fiton me dy gola ndaj Bjellorusisë



Mirë se vjen, Ambasador Wendt!



Presidenti Begaj zbarch takimin me ambasadorin e ri të SHBA, Eric Wendt



SPAK aksion në Shkodër e Tiranë! Arrestohet një person, Endrit Dokle sërish në kërkim

TË PËRZGJEDHURA



Singapori paguan qytetarët për të lexuar: 15 minuta në ditë në këmbim të parave



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hije! Balluku-lokomotivë shtetto...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...

MË TË LEXUARAT

investon, organizon dhe udhëheq. Është thjesht një njeri që sheh fëmijët duke u gëzuar.

Pastaj vështrimi i tij ndalet te një prej simboleve të këtij këndi, një anije e vendosur mes hapësirës së lojërave. Fëmijët kanë hipur mbi të. Luajnë. Imagjinojnë. Lundrojnë në një det që nuk ekziston, por që për ta është krejtësisht i vërtetë.

Dhe Luca u drejtohet: "A keni nevojë për një kapiten?"

Ndoshta kjo është edhe metafora më e bukur e kësaj dite.

Fëmijët nuk kanë nevojë vetëm për vende ku të luajnë. Ata kanë nevojë për të rritur që t'u krijojnë hapësirë ëndrrave të tyre. Kanë nevojë për njerëz që të besojnë se e ardhmja nuk është diçka që thjesht pritet, por diçka që ndërtohet.

Një fëmijë që sot hipën mbi një anije lodër, nesër mund të bëhet kapiten i një anijeje të vërtetë. Ai që sot luan me një ide, nesër mund ta kthejë atë në një vepër. Ai që sot sheh vetëm një fushë loje, nesër mund të shohë një botë për t'u ndërtuar.

Kjo është arsyeja pse një hapësirë për fëmijët nuk është thjesht një kënd argëtimi.

Është një investim në imagjinatë.

Dhe imagjinata është shpesh fillimi i çdo qyteti, i çdo vepre, i çdo të ardhmeje.

Nëse Fish City Apolloni është një dëshmi e asaj që mund të bëjë një ide kur bashkohet me punën, përkushtimin dhe këmbënguljen, kjo ditë mes fëmijëve është një dëshmi tjetër, se ajo që ndërtojmë merr kuptim kur u shërben njerëzve.

Sepse në fund, përtej betonit, çelikut, teknologjisë, sipërmarrjes dhe shifrave, mbetet njeriu.

Dhe nëse ka një matës që nuk gënjen, ai është zëri i një fëmije që qesh.

Ndoshta vlera më e madhe e një vendi nuk është ajo që shohim kur ngremë sytë, por ajo që ndodh kur ulim vështrimin te fëmijët.

Një qytet mund të ndërtohet me duar.

Një biznes mund të ngrihet me guxim.

Një ëndërr mund të bëhet realitet me punë.

Por lumturia e një fëmije nuk ndërtohet me pasuri; ajo kërkon zemër.

Dhe kur një sipërmarrës ndalet mes fëmijëve, i sheh duke luajtur dhe pyet: "A keni nevojë për një kapiten?", ai, ndoshta pa e menduar, na kujton diçka të thjeshtë: Të ndërtosh për të ardhmen do të thotë, para së gjithash, t'u lësh fëmijëve një vend ku ata mund ta imagjinojnë atë.

ETIKETA ALBERT VATAJ APOLLONI FISH CITY GJERGJ LUCA ROZAFA

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Pesticidet në fruta e perime/ Agronomët kërkojnë protokoll të ri dhe ...

Në kërkim nga Italia dhe Kosova, arrestohen dy persona

Dy operacione të policisë, arrestohet 66-vjeçari me automatik dhe sek...



Ish-deputeti Azgan Haklaj nuk lejohet të hyjë në Maqedoninë e Veriut ...




Kapet furgoni me 90 kg kanabis, arrestohen shoferi dhe pasagjeri



Tiranë/ Goditen grupet që shisnin drogë pranë shkollave, 31 në burg d...

LAJMET E FUNDIT



Pesticidet në fruta e perime/ Agronomët kërkojnë protokoll të ri dhe përdorim të preparateve me karencë të shkurtër


19 MINUTA MË PARË

Në kërkim nga Italia dhe Kosova, arrestohen dy persona

59 MINUTA MË PARË

Dy operacione të policisë, arrestohet 66-vjeçari me automatik dhe sekuestrohet "Benz"-i i kërkuar nga Interpol

1 ORË E 9 MINUTA MË PARË



Ish-deputeti Azgan Haklaj nuk lejohet të hyjë në Maqedoninë e Veriut se "përbën rrezik për sigurinë kombëtare m...

1 ORË E 29 MINUTA MË PARË



Kosovë/ Dyshohen për krime lufte, arrestohen 9 persona në Zubin Potok

1 ORË E 42 MINUTA MË PARË



Kapet furgoni me 90 kg kanabis, arrestohen shoferi dhe pasagjeri

2 ORË E 29 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONË

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frashëri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.